



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.970/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Zyhdi Haziri kryesues, Ymer Hoxha dhe Afijete Sada Gillogjani anëtarë, si dhe me pjesëmarrjen e Zyrtarit Ligjorë Ardian Maxhuni, duke vendosur përkitazi me apelin e kandidatit për anëtarë të Kuvendit Komunal në Malishevë Arsim Krasniqi nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, dega në Malishevë, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017 për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur më datë 12.11.2017, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si i pabazuar apeli i parashtruar nga kandidati Arsim Krasniqi nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, dega në Malishevë me shenjë ZL.Anr.970/2017 të datës 10.11.2017, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017 pas shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017,

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një apel me datë 10.11.2017, nga Arsim Krasniqi nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, dega në Malishevë, në apelin e tij ka pretenduar se në vendvotimin nr. 3032A/02r nuk më figuron asnjë votë. Më tutje ka theksuar se në shkollën “Hilmi Hoti” në Qendrën e Votimit QV nr. 3036/02rmë kanë dalur vota të konsiderueshme të pavlefshme, prandaj PZAP-it i ka kërkuar që të hapen kutit e votimit pasi që votat e pa vlefshme dyshoj se figurojnë për mua me numrin 9 të kandidaturës.

PZAP-i, pas shqyrtimit të bazueshmerise së apelit dhe vlerësimit të pretendimeve ne apel, që gjenden në shkresat e lëndës, në mbështetje të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është e pabazuar

Paneli pas vlerësimit te pretendimeve në apel gjeti se parashtruesi i apelit nuk ka bashkangjitur asnjë prove bindëse për te mbështetur pretendimet e tij në apel.

Prandaj, apelin e konsideron si të përgjithësuar dhe të pa argumentuar me fakte dhe si të tillë jo bindëse pasi që nuk i plotëson kërkesat ligjore të përcaktuara me dispozitën e nenit 117 i Ligjit nr. 03/-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme të Republikës së Kosovës.

Rrjedhimisht PZAP-i në mungesë të provave dhe dëshmive konkrete dhe bindëse për pretendimet e paraqitura në apel, konstaton se apeli në fjalë është i pabazuar dhe i pa argumentuar dhe si të tillë apelin e refuzoj.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë në mbështetje të nenit 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr.970/2017 më datën 12.11.2017.

Kryesuesi i Panelit
Zyheri Haxhiu



Këshillë Juridike:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*